

INFORMACIONE PËR PROJEKTIN

Përmirësimi i Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Republikës së Moldavisë



Minierë qymyri e hapur dhe
termocentrali Pljevlja, Mali i Zi
Burimi: iStock (103606346, goce)

Përmbledhje

Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR) janë regjistra shumë të rëndësishëm për të siguruar të drejtën e marrjes së informacionit për komunitetin dhe për të përmirësuar aksesin në informacionin mbi ndotësit, shkarkimet dhe transferimet e mbetjeve jashtë vendit të prodhimit të tyre. Disa vende të Ballkanit Perëndimor kanë përparuar më mirë në zhvillimin e PRTR. Shqipëria dhe Moldavia synojnë përmirësimin e sistemeve të tyre, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina (BH), Kosova dhe Mali i Zi kanë shprehur nevojën e tyre për to. Partnerët e projektit, me përjashtim të BH dhe Kosovës, janë palë në Protokollin e PRTR të UNECE. Të gjithë partnerët janë të interesuar ti zhvillojnë sistemet e tyre drejt një sistemi të raportimit të integruar të E-PRTR & Impianteve e mëdha me Djegie (LCP), Regjistrin të BE- së për Impiantet Industriale dhe Direktivës së BE- së mbi Shkarkimet Industriale.

Të dhëna rreth projektit

Projekti mbështet vendet partnere të saj për të zhvilluar ose përmirësuar regjistrat e PRTR. Ai do t'iu mundësojë autoriteteve përkatëse, operatorëve dhe OJF-të zbatimin e raportimit të integruar E-PRTR & LCP, raportimin në Regjistrin e BE-së mbi për Impiantet Industriale, Direktivën e Shkarkimeve Industriale dhe Protokollin PRTR të UNECE. Qëllimi është të arrihet informimi i vendimmarrësve për qëndrueshmërinë. Si rezultat i ndihmës teknike, ndërtimit të kapaciteteve dhe ndarjes së përvojës, të transferimit, zbatimit të legjislacionit përkatës të BE-së dhe Protokollit PRTR të UNECE, autoritetet kompetente përgjegjëse do të kenë PRTR-të funksionale dhe raportim të rregullt online nga operatorët. Ky sistem siguron më shumë informacion rreth rreziqeve të mundshme të ndikimit të ndotësve dhe transferimit të tyre për publikun. Ai fuqizon shoqërinë civile të ndërmarrë veprime kundër ndotjes në komunitetet e tyre, industrinë për të zvogëluar shkarkimet dhe vendimmarrësit për të zhvilluar dhe zbatuar programet e reduktimit të ndotjes: duke përparuar drejt standarteve evropiane mjedisore dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Përditësuar: Maj 2021

Vendet pjesëmarrëse në projekt:
Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina,
Kosova, Moldavia, Mali i Zi
Kohëzgjatja: 05/2021 – 05/2023
Përfituesit: Pikat Kombëtare të kont-
aktit dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës
për PRTR, operatorët, OJF-të
Organizatat Zbatuese: Participatio
Environmental Policy Advisory Ltd.,
së bashku me, Qendrën Burimore të
Mjedisit në Shqipëri, Qendrën
Burimore të Mjedisit në BH,
Komunitetin e Burimeve Mjedisore
në Mal të Zi dhe EcoContact,
Moldova.
Numri i Projektit: 156360

Menaxhimi Tematik:

Agjencia Gjermane e Mjedisit
(UBA) Sabine Grimm
Tel.: +49-340-2103-2954
sabine.grimm@uba.de

Koordinator i projektit:

AAP Njësia e Projekteve
Dr. Sonja Otto
Tel.: +49-340-2103-2210
sonja.otto@uba.de

Programi i Ndhmës Këshillimore (AAP)

për mbrojtjen e mjedisit në vendet e
Evropës Qendrore dhe Lindore,
Kaukazit dhe Azisë Qendrore dhe
vendeve të tjera fqinje me Bashkimin
Evropian – një program i Ministrisë
Federale për Mjedisin, Ruajtjen e
Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore

AAP Njësia e projekteve:

AAP-info@uba.de

[www.uba.de/en/project-database-
advisory-assistance-programme](http://www.uba.de/en/project-database-advisory-assistance-programme)
[www.uba.de/en/advisory-assistance-
programme](http://www.uba.de/en/advisory-assistance-programme)